



Planuar / Dorezuar Priljeft/Prodato Received/Delivory	15-05-2023	3	viti god year
Organ /Njësia Organ./Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHCK	4247/2023		115



Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.592/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.592/2023 të datës 31.03.2023 të ankuesit

kundër organit të punësimit Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenin 47, 48 paragrafi 1 dhe neni 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrativ dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 15.05.2023, mori këtë.

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr. 592/2023 e datës 31.03.2023, e parashtruar nga ankuesi

II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër 259 i datës 16.03.2023, i Komisionit të Vlerësimit në Agjencinë e Punësimit në Republikën e Kosovës.

A r s y e t i m

Ankuesi sipas shkresave të lëndës i punësuar në kuadër të Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës (tutje APRK), me datë 31.03.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër 259 të datës 16.03.2023 të Komisionit të Vlerësimit, me pretendimet ankimore se i është mohuar e drejta për avancim në karrierë, respektivisht zhvillimi i procedurës së rekrutimit

për pozitën "Udhëheqës i Zyrës së Punësimit-Zyra e Punësimit në Pejë", nga Agjencia e Punësimit në Republikën e Kosovës ka qenë i padrejtë dhe në kundërshtimi me ligjin .

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (me tej KPMSHCK) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 07.04.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Agjencia e Punësimit në Republikën e Kosovës, ndërsa me datë 28.04.2023, KPMSHCK-ja ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vendosje meritore, ka administruar këto prova: Ankesën A nr. 592/2023, e datës 31.03.2023, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Foto e komunikimeve ne telefon; Vendimi i Komisionit të Vlerësimit me numër 259 i datës 16.03.2023; Njoftimi për përfundimin e procedurës me numër 226 i datës 07.03.2023; Vërtetimi i Agjencisë së Punësimit të republikës së Kosovës me numër 561 i datës 03.12.2021; E-mail i dërguar nga E.Z dërguar S.A i datës 01.03.2023; Shkresë- Profili i ankuesit në SIMBNJ; E-mail i dërguar nga S.S drejtuar S.A i datës 15.11.2022; E-mail i dërguar nga S.S drejtuar S.A i datës 15.11.2022; E-mail i dërguar nga S.A drejtuar S.S i datës 25.11.2022; Konkurs i datës 27.12.2022; E-mail i dërguar nga DBNJ/ APRK dërguar S.A i datës 26.01.2023; Trajnim i këshilltarëve në Hochschule Luzern dhe Boost employment; Agjenda e trajnimit Hochschule Luzern, Coaching for employment dhe Boost employment bashkangjitur m korrespondencën prej 1- 5 faqe; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 07.04.2023; Përgjigja në ankesë e datës 28.04.2023; Vendimi për themelimin e komisionit të vlerësimit me numër 52 i datë 20.01.2023;Akt emërimi për J.R i datës 07.11.2018; Vendim me numër prot 917 i datës 06.05.2022; Akt emërim për S.G i datës 30.11.2018; Vendim me numër 778 i datës 23.09.2020; E-mail i dërguar nga S.S drejtuar DMZP i datës 25.04.2023; Njoftim me numër 99 i datës 02.02.2023; Njoftim me numër 161 i datës 14.02.2023; Aplikacioni i A.L bashkangjitur me dosjen e kandidatit; Aplikacioni i S.A bashkangjitur me dosjen e kandidatit; Aplikacioni i XH.S bashkangjitur me dosjen e kandidatit; Renditja përfundimtare e kandidatëve e datës 06.03.2023; Njoftimi për përfundimin e procedurës me numër 265 i datës 17.03.2023; Ankesa e drejtuar në Agjencinë e Punësimit me numër 401 i datës 10.03.2023; Ankesa me numër 400 e datës 10.03.2023; Abstrakt i hulumtimit; Punim shkencor Biznes, Administratë dhe Shkenca Shoqërore i vitit 2021; E-mail i dërguar nga DBNJ/ APRK drejtuar S.A e datës 15.12.2022; E-mail i dërguar nga DBNJ/ APRK i datës 25.11.2022; E-mail i dërguar nga DBNJ/ APRK drejtuar S.A e datës 26.01.2023; E-mail i dërguar nga S.A drejtuar S.S e datës 15.11.2022; E-mail i dërguar nga S.S drejtuar S.A e datës 15.11.2022; E-mail i dërguar nga S.A drejtuar S.S e datës 15.11.2022; E-mail i dërguar nga S.S drejtuar M.K i datës 15.11.2022; E-mail i dërguar nga S.A drejtuar S.S e datës 15.11.2022; E-mail i dërguar nga S.A drejtuar S.S e datës 15.11.2022;Email i dërgua nga S.A drejtuar M.K e datës 25.11.2022; E-mail i dërguar nga S.S drejtuar S.A i datës 28.02.2022; Pyetjet e intervistës e datës 06.03.2023; E-mail i dërguar nga DMZP drejtuar KPMSHCK i datës 08.05.2023; Formulari i vlerësimeve individuale nga anëtarët e Komisionit i gjeneruar nga SIMBNJ i datës 08.05.2023.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e pa bazuar sepse:



Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave bazuar në shkresat e lëndës, gjegjësisht sipas Akt Emërimit të datës më numër:42, të datës 28.12.2017 ka konstatuar se ankuesi mban pozitën e punës *"Zyrtar për Shërbime të Punësimit"* dhe i njëjti sipas shkresave të lëndës është konstatuar se ka aplikuar në konkursin e shpallur me numër referencë RN00010387 për pozitën *"Udhëheqës i Zyrës së Punësimit-Zyra e Punësimit në Pejë"*, të shpallur nga Agjencia e Punësimit të Republikës së Kosovës, ndërsa sipas Njoftimit për përfundimin e procedurës me numër:265 të datës 17.03.2023 rezulton se procedura e konkurrimit *"Ngritje(Avancim) në detyrë"* ka përfunduar pa kandidatë fitues.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, lidhur me pretendimet ankimore të ankuesit ka konstatuar se në konkursin për ndritje(avancim) në detyrë të shpallur me datë 27.12.2022 me numër Reference RN00010387 për titullin e pozitës së punës *"Udhëheqës i Zyrës së Punësimit-Zyra e Punësimit në Pejë"* klasa e pozitës *"Drejtues i Ulët 2"*, sipas njoftimit të datës 02.02.2023 duke u bazuar në nenin 45 dhe 57 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës ku thuhet se: *"Verifikimi paraprak është procesi i verifikimit nëse kandidati plotëson kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e veçanta për pozitën e lirë për të cilën konkurrohet"* dhe si rrjedhojë Njësia e Burimeve Njerëzore pas verifikimit paraprak të aplikacioneve ka vendosur se në listën e ngushtë të kandidatëve që i plotësojnë kushtet dhe kriteret për aplikim ka qenë tre kandidatë, ku ndër ta ka qenë edhe ankuesi

Po ashtu, Kolegji i Këshillit lidhur me pretendimet ankimore të ankuesit se zyrtarja e Burimeve njerëzore një ditë para mbylljes së konkursit kishte dërguar E-mail zyrtar të datës 26.01.2023 ku specifikon se cilat dokumente duhet të bashkëngjiten gjatë aplikimit në konkurs dhe si kriter kishte shtuar edhe *"Dëshminë e gjuhës angleze"* e i cili kriter nuk është i paraparë me konkursin në fjalë, Kolegji i Këshillit pas administrimit të shkresave të lëndës ka gjetur se një E-mail i tillë është dërguar nga E-maili zyrtar i DBNJ e i cili ka karakter për informimin/ndërgjegjësimin e zyrtarëve për mënyrën e aplikimit në konkurse të ndryshme dhe i njëjti njoftim i është dërguar përmes E-mailave të datës 29.11.2022 dhe 26.01.2023 drejtuar të gjithë zyrtarët e APRK pa përjashtim duke bashkëngjitur edhe linkun e publikuar në platformën youtube përmes së cilës zyrtarët mund të njoftohen më mirë rreth mënyrës së aplikimit, prandaj faktin se E-maili nuk ka pasur qëllim diskriminues për ankuesin e ka vërtetuar edhe nga njoftimi i datës 02.02.2023 ku ankuesi ka hyrë në listën e ngushtë të kandidatëve të cilët kanë plotësuar kushtet dhe kriteret e konkursit pas verifikimit paraprak, nga rrjedh se pretendimi ankimor i ankuesit është i pabazuar.

Tutje, Kolegji i Këshillit sa i përket pretendimeve ankimore të ankuesit se gjatë intervistimit me gojë ankuesi i është përgjigjur të tre (3) pyetjeve në mënyrë të kënaqshme dhe se vlerësimi me gjithsejtë 2.33 pikë ka qenë i ulët duke marrë parasysh përgjigjet e dhëna duke pretenduar se Komisioni është dashur ta vlerësoj me së paku me pesë (5) pikë, Kolegji ka shikuar procesverbalin e intervistës së datës 06.03.2023 dhe ka konstatuar se gjatë intervistës Komisioni i kishte përgatitur 5 pyetje ku në bazë të përgjigjeve të dhëna anëtarët e Komisionit kishin vlerësuar kandidatin në mënyrë individuale duke arritur kështu të mbledhë një mesatare prej dy pikë tridhjetë e tre (2.33) pikë, ndërsa për kundër pretendimit të ankuesit se zyrtarja e Burimeve Njerëzore kishte ndërhyrë gjatë dhënies së përgjigjes në intervistës me tendencë hakmarrje për një keqkuptim të mëhershëm, Këshilli në bazë të formularit të



vlerësimeve individuale të anëtarëve të Komisionit ka vërtetuar se e njëjta kandidatin e kishte vlerësuar me më shumë pikë në krahasim me anëtarët e tjerë të Komisionit, nga rrjedh se pretendimi ankimor i ankuesit është i pabazuar ndërsa veprimi i anëtarëve të Komisionit është bërë në pajtueshmëri me nenin 62 paragrafi 2, 4 dhe 5 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës ku thuhet se: "2. Në intervistë, vlerësohen njohuritë, aftësitë apo cilësitë e kërkuara për pozitën përkatëse të punës që nuk mund të vlerësohen nëpërmjet testimit me shkrim; 4. Komisioni i Vlerësimit përgatit apo zgjedh grup pyetjesh të njëjta për të gjithë kandidatët për intervistën me gojë në ditën e zhvillimit të intervistës. 5. Vlerësimi maksimal në intervistën me gojë është dhjete (10) pikë" ndërlidhur edhe me nenin 48 paragrafi 1 dhe nenin 63 të së njëjtës rregullore.

Po ashtu, duke ju referuar Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës ka përcaktuar kushtet, kërkesat e veçanta dhe procedurën, për ngritjen në detyrë, përkatësisht me nenin 49 paragrafi 2 dhe 3 ndërlidhur me nenin 63 të kësaj rregullore përcaktohet se: "2. Kandidati që është vlerësuar me më shumë pikë dhe që ka marrë të paktën gjashtëdhjetë (60) pikë është kandidati fitues dhe ka të drejtën të emërohet në pozitën e lirë për të cilën është zhvilluar konkurrimi. Kandidati fitues në rastin e kandidatëve me pikë të barabarta përcaktohet, nga NJBNJ sipas nenit 27 të kësaj Rregulloreje, dispozitat e të cilit zbatohen përshtatshëmrisht. 3. Nëse asnjë nga kandidatët nuk është vlerësuar me gjashtëdhjetë 60 e më shumë pikë, procedura e lëvizjes brenda kategorisë përfundon pa kandidat fitues.", Kolegji i Këshillit konstaton se ankuesi në procedurën e rekrutimit për ngritje (avancim) në detyrë për pozitën e punës "Udhëheqës i Zyrës së Punësimit-Zyra e Punësimit në Pejë" është vlerësuar gjithsejtë me pesëdhjetë e katër pikë nëntëdhjetë e nëntë (54.99) pikë të cilat janë të pamjaftueshme për tu zgjedhur kandidatë fitues ashtu siç përcaktohet edhe me dispozitën ligjore specifiku me nenin 49 paragrafi 3 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ndërsa nga shqyrtimi i lëndës Kolegji i Këshillit nuk ka gjetur elemente të shkeljeve në procedurën e rekrutimit, ndërsa pretendimet e ankuesit janë refuzuara si të pabazuara sikurse në arsyetimin e këtij vendimi.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se Komisionit të Vlerësimit për Ngritje në Detyrë në Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës, me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër: 259 të datës 16.03.2023 përmes të cilit është refuzuar ankesa e ankuesit, ndërsa ka lënë në fuqi Njoftimi me numër protokolli:226 të datës 07.03.2023 të Zv. Udhëheqësit të Divizionit për Burime Njerëzore në APRK është vepruar në pajtim me nenin 39 të Ligjit Nr. 06/LI-114 për Zyrtarët Publikë sikurse edhe nenin 63 dhe 64 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, dhe po ashtu ky vendim i goditur përmes kësaj ankese përmban elementet e aktit administrativ, ndërsa arsyetimi i tij është në pajtim me nenin 47 dhe nenin 48 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, pasi që kanë vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike ngase pretendimet ankimore të ankuesit janë të pabazuara në dispozitat e ligjit material dhe akteve nënligjore që rrjedhin prej tij.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe neni 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.




Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër **A.nr.592/2023**

Flakron Gashi



Procesmbajtës

Malsore Gashi-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Punësimit në Republikën e Kosovës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Agjencinë e Punësimit në Republikën e Kosovës, dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.